



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

4270/16
Nr. _____ prot.

Tiranë, më 25.2018

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 63, datë 2.5.2018

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA DURRËS.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 3, datë 21.3.2018 “Për miratim të ndryshimeve të statutit të shoqërisë”, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës, pasi shqyrtova praktikën e dërguar nga shoqëria me shkresën nr. 243/1, datë 7.3.2018;

VENDOSA

- Miratimin e disa ndryshimeve të statutit të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës si më poshtë:
 - Në të gjitha nenet e statutit ku përmendet shprehja “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” (Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve), të zëvendësohet me shprehjen “Ministria Përgjegjëse për Ekonominë” (Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve).
 - Në statutin e shoqërisë shtohet një nen me këtë përmbajtje:
“Administratori i shoqërisë emërohet dhe lirohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve”.
- Bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR

Arben Ahmetaj